



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të rregullave 46 dhe 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 12 tetor 2009, pasi shqyrtoi Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011.
2. Ngarkohen Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Institucionet e tjera, përgjegjëse nga fushëveprimi i tyre, që ta zbatojnë Strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhe Kuvendit t'i raportojnë për zbatimin e saj.

Nr. 03-V-179
Prishtinë, më 12 tetor 2009

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Vendimi dhe Strategjia t'i dërgohen:

- Qeveris së Republikës së Kosovës,
- Agjencisë Kundër Korrupsionit,
- Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

STRATEGJIA KUNDËR

KORRUPSIONIT

2009 - 2011

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SITUATËN AKTUALE NË KOSOVË	4
II. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KORRUPSIONIT 2004 - 2007	5
III. NEVOJA PËR NJË STRATEGJI TË RE KUNDËR KORRUPSIONIT	6
IV. PUNA PËRGATITORE PËR PËRPILIMIN E STRATEGJISË	7
V. PËRKUFIZIMI I KORRUPSIONIT	7
VI. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË STRATEGJISË.....	8
KAPITULLI I. PARIMET	9
KAPITULLI II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË STRATEGJISË	10
KAPITULLI III. SEKTORËT PRIORITARË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË	10
I. SEKTORI POLITIK.....	10
II. QEVERISJA LOKALE.....	11
III. ADMINISTRATA PUBLIKE QENDRORE	12
IV. AGJENCITË MONITORUESE, TË ZBATIMIT TË LIGJIT DHE GJYQËSORI.....	13
V. FINANCAT PUBLIKE DHE MENAXHIMI I TYRE	14
VI. SEKTORI PRIVAT/VEPRIMET E BIZNESIT	15
VII. SHOQËRIA CIVILE	16
KAPITULLI IV. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	16
KAPITULLI V. MIRATIMI, MONITORIMI DHE ZBATIMI I STRATEGJISË.....	17

Hyrje

i. Informacion i përgjithshëm mbi situatën aktuale në Kosovë

Situata e përgjithshme në Kosovë është e karakterizuar nga tiparet e vendeve në tranzicion. Bazuar në të dhënat e studimeve e raporteve të ndryshme të publikuara gjatë viteve 2007-2008, të cilat paraqesin një analizë të situatës, perceptimit publik, shkaqeve dhe pasojave të korrupsionit, vihet re qartë se problemi i korrupsionit është ende shumë i përhapur dhe përbën një problem shumë serioz¹, i cili minon mirëfunksionimin e institucioneve si dhe ndikon në krijimin e imazhit të keq të vendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e saj i ka dhënë prioritet këtij sektori, duke e renditur si prioritet kryesor luftimin e korrupsionit në kuadër të qeverisjes së mirë. Qeveria do të mbështesë iniciativat e ndërmarra në Strategjinë kundër Korrupsionit në Kosovë të zhvilluar tashmë dhe do të ndërmarrë masa konkrete për të shtyrë përpara zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës institucionale dhe ligjore në funksion të luftimit të dukurisë së korrupsionit në cdo fushë. Qeveria do të bashkëpunojë dhe forcojë partneritetin me shoqërinë civile dhe mediat për të fuqizuar rolin e tyre në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave kundër korrupsionit dhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organeve qeveritare dhe jo-qeveritare në Kosovë.

Komisioni Evropian ka identifikuar një numër boshllëqesh dhe dobësish në fushën e politikës, duke përfshirë këtu administratën publike dhe politikën kundër korrupsionit.² Në veçanti, vlerësohet se nëpunësit civilë janë ende të prekur nga ndërhyrjet politike, praktikat korruptive dhe nepotizmi. Shqetësime janë ngritur dhe për transparencën e aktiviteteve të Kuvendit, bashkëpunimit të dobët midis Qeverisë dhe Avokatit të Popullit, pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit, efektivitetit të organeve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit kur merren me çështje korruptive, gjendja e stafit dhe garancitë për paanshmërinë në funksionimin e Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit. Gjithashtu në fushën e zhvillimit ekonomik korrupsioni përmendet si një pengesë shumë e madhe e aktivitetit ekonomik. Një numër problemesh që kanë të bëjnë me gjendjen e korrupsionit lidhen dhe me fushën e standardeve evropiane, duke përfshirë tatimet, konkurrencën, prokurimet publike, shoqëritë e informimit dhe mediat, kontrollin financiar, luftën kundër pastrimit të parave, drogës dhe krimit të organizuar si dhe punën e policisë. Në lidhje me ato që u përmenden më sipër, Vendimi i Këshillit të Komisionit Evropian i datës 18 shkurt 2008 për parimet, prioritetet dhe kushtet që përmban dokumenti i Partneritetit Evropian parashtron si prioritate afatshkurtër për Kosovën, ndjekjen e politikës së tolerancës zero kundër korrupsionit.³

¹ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2008 dhe Raporti i Nr 20/21 i UNDP-së për Paralajmërimin e Hershëm.

² Raporti i Progresit nga Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2007 dhe Raporti i Progresit për vitin 2008.

³ Vendim i Këshillit i datës 18 shkurt 2008 mbi parimet, prioritetet dhe kushtet që përmban dokumenti i Partneritetit Evropian me Serbinë, duke përfshirë dhe Kosovën sic është e përcaktuar nën Rezolutën e Këshillit të Kombeve të Bashkuara 1244 të 10 qershorit 1999 dhe shfuqizimi i Vendimit 2006/56/EC (2008/213/EC) si dhe Raporti i Progresit për vitin 2008.

Sipas Barometrit Global të Korrupsionit 2007, të organizuar nga Transparenca Ndërkombëtare, në Kosovë, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve kanë dëshmuar se kur kanë dashur të marrin shërbime është dashur të paguajnë ryshfet. Në të njëjtën kohë, shumica e të anketuarve mendojnë se përpjekjet e qeverisë për të luftuar korrupsionit janë jo-efikase.⁴

Për më tepër, Raportet Vjetore për vitin 2007 dhe vitin 2008 mbi aktivitetet e Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit, paraqesin të dhëna problematike mbi rastet e korrupsionit të raportuara, të cilat shihet se kanë shpërndarje më të madhe në qeveri, gjykata, qeverisje lokale dhe ndërmarrjet publike.⁵

Megjithë problemet e ndeshura më sipër, renditja e korrupsionit për vitin 2007 e realizuar nga "Freedom House" tregon përmirësim në këtë fushë, si rezultat i disa aktiviteteve konkrete të ndërmarra kundër korrupsionit dhe sukseseve të arritura në Kosovë.⁶ Gjithashtu, më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se në tre vjetët e ardhshëm, niveli i korrupsionit në Kosovë do të bjerë.⁷

E megjithatë, të dhënat e fundit që vijnë nga Raporti i Paralajmërimit të Hershëm të organizuar nga zyra e UNDP-së në Kosovë nuk janë shumë optimiste dhe tregojnë se është ende e lartë përqindja e qytetarëve të cilët mendojnë se korrupsioni është i pranishëm në nivele të larta në shumë institucione. Sipas perceptimeve të qytetarëve institucionet të cilat kanë nivel të lartë të korrupsionit janë KEK-u, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, shërbimi shëndetësor, policia e UNMIK-ut, gjykatat, doganat dhe administrata qendrore⁸.

ii. Vështrim i përgjithshëm mbi zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit 2004 - 2007

Një vështrim i përgjithshëm mbi zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit në Kosovës 2004 -2007, tregohet një progres i dukshëm i arritur në të tri fushat e synuar nga kjo strategji, përpilimi dhe miratimi i politikave dhe legjislacionit kundër korrupsionit, krijimi i mekanizmave për vetëdijesimi e opinionit publik dhe institucioneve vendimarrëse.

Instrumentet kryesore ligjore në fushën e parandalimit të korrupsionit janë miratuar, duke përfshirë këtu Ligjin kundër Korrupsionit (prill 2005), Ligjin për Qasjen në Dokumentat Zyrtare (nëntor 2003) dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike (nëntor 2007).

⁴ Raport i Transparencës Ndërkombëtare, Barometri Global i Korrupsionit 2007.

⁵ Raporti vjetor i Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit për vitin 2007 dhe 2008, <http://www.akk-ks.org>

⁶ Freedom House, Shtetet në Tranzicion 2008/Raporti për Kosovën.

⁷ Raport i Transparencës Ndërkombëtare, Barometri Global i Korrupsionit 2007.

⁸ Raporti i Nr 20/21 i UNDP-së për Paralajmërimin e Hershëm.

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit (AKK) - institucioni kryesor kundër korrupsionit përgjegjës për zbulimin, parandalimin dhe kryerjen e hetimeve administrative mbi rastet korruptive është funksional që prej shkurtit të vitit 2007.

Disa fushata vetëdijësuese për opinionin publik janë organizuar nga Qeveria e Kosovës me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë (OSBE dhe UNDP), në bashkëpunim me organizatat joqeveritare vendore. Gjithashtu, është organizuar në vitin 2005 Hulumtimi mbi perceptimin qytetar për korrupsionin nga Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, me mbështetjen e UNDP-së në Kosovë.

Strategjia kundër Korrupsionit që mbulonte periudhën 2004-2007, kishte një qasje shumë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, duke u përpjekur që të prekte të gjitha fushat. Për shkak se strategjia kishte një qasje kaq të gjerë, në një farë mënyre rrezikoi zbatimin e plotë dhe efektiv të këtij dokumenti politikash, në atë kohë i pari dokument politikash kundër korrupsionit i hartuar në Kosovë.

Megjithatë, u krijua kuadri përkatës ligjor dhe institucional kundër korrupsionit, një numër problemesh të cilat ndikuan në zbatimin jo të duhur të Strategjisë kundër Korrupsionit janë identifikuar. Problemet kryesore të cilat minuan përpjekjet për zbatimin efektiv të objektivave kundër korrupsionit dhe masave përkatëse janë të lidhura me:

- mungesën e vullnetit politik;
- planifikimin i cili nuk mori parasysh burimet që disponoheshin në atë kohë dhe kapacitetet e institucioneve;
- mungesa e përkrahjes së duhur financiare dhe alokimi i fondeve për zbatimin e masave kundër korrupsionit;
- mungesa e personelit me përvojë (të specializuar), të trajnuar dhe të motivuar, si dhe mungesat në personel të institucioneve kyçe;
- mungesa e kontrollit dhe mbikëqyrjes së duhur për zbatimin e masave nga ana e strukturave qeveritare përgjegjëse, duke përfshirë këtu probleme të koordinimit, bashkëpunimit dhe komunikimit;
- mungesa e reagimeve dhe mosdashja nga ana e institucioneve për të raportuar në mënyrë periodike mbi statusin e masave përkatëse të shoqëruar dhe me mospërgjegjshmërinë në realizimin e masave; si dhe
- mungesa e presionit dhe mbikëqyrjes nga ana e shoqërisë civile, duke përfshirë këtu organizatat joqeveritare vendase dhe mediat.

iii. Nevoja për një strategji të re kundër korrupsionit

Në përputhje me dispozitat e Ligjit kundër Korrupsionit që parashohin çështjet të cilat lidhen me hartimin dhe zbatimin e strategjive duke pasur parasysh se Strategjia kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit mbulonin periudhën kohore 2004-2007, Agjensioni

ndërmori iniciativën për të përpiluar dhe propozuar për miratim Strategjinë e re kundër Korrupsionit⁹.

Rrethanat e mëposhtme, të cilat u morën parasysh, e justifikojnë nevojën për miratimin e një strategjie të re:

- gjendja aktuale e reformave anti-korrupsion dhe kuadri ligjor anti-korrupsion pothuajse i plotësuar si dhe kuadri institucional i sapokrijuar;
- statusi i ri dhe i pavarur i Kosovës si dhe miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- nevoja për krijimin e kushteve për pjesëmarrjen efektive në bashkëpunimin ndërkombëtar kundër korrupsionit, duke përfshirë konventat ndërkombëtare dhe mekanizmat monitorues;
- nevoja për të ngritur efikasitetin, pavarësinë dhe autonominë e institucioneve të cilat janë përgjegjëse për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe gjykimin e korrupsionit;
- nevoja për t'i fokusuar përpjekjet dhe për të vendosur prioritete të qarta dhe realiste kundër veprimet e ardhshme anti-korrupsion, duke përfshirë zbatimin e duhur të politikave kundër korrupsionit, kuadrit ligjor dhe forcimit të kapaciteteve institucionale;
- nevoja për të rritur përpjekjet për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut duke synuar parandalimin e fenomenit të korrupsionit; si dhe
- nevoja për të ngritur dhe zhvilluar koordinimin efikas midis mekanizmave të ndryshëm anti-korrupsion në vend.

iv. Puna përgatitore për përpilimin e strategjisë

Në vijim të procesit të konsultimeve dhe diskutimeve paraprake të mbajtura nga grupi i brendshëm punues i Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit gjatë tremujorit të parë të 2008-ës, në qershor 2008, Agjensioni inicoi përgatitjen e Strategjisë së re kundër Korrupsionit dhe thirri mbledhjen e parë të Grupit Punues Ndër-institucional, ku u ftuan të merrnin pjesë të gjithë institucionet përgjegjëse. Duke marrë parasysh nevojën për transparencë dhe në mënyrë që të sigurohej një pjesëmarrje sa më e gjerë, përfaqësues të shoqërisë civile (prej organizatave joqeveritare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e anti-korrupsionit, mediave, komunitetit të biznesit, etj.) u ftuan për të marrë pjesë si anëtarë të Grupit Punues Ndër-institucional. Grupi Punues mbajti pesë takime gjatë muajve qershor dhe korrik 2008, dhe dokumenti i strategjisë u finalizua gjatë një punëtorie që u mbajt më datat 30 dhe 31 korrik 2008 në Ohër, Maqedoni.

v. Përkufizimi i korrupsionit

Duke pasur parasysh nevojën për të pasur një qasje gjithëpërfshirëse për të zhvilluar dhe zbatuar politikat kundër korrupsionit dhe për qëllim të kësaj strategjie korrupsioni

⁹ Raporti i Progresit nga Komisioni Evropian për Kosovën, viti 2008 .

përkufizohet si "keqpërdorim i pushtetit/përgjegjësiwe të dhëna në sektorin publik ose privat për përfitim personal".

Përkufizimi i përgjithshëm i dhënë më sipër mbulon korrupsionin në sektorin publik por edhe korrupsionin tek partitë politike, sektorin e biznesit privat, shoqatat, organizatat joqeveritare dhe tek shoqëria në përgjithësi. Gjithashtu, ky përkufizim reflekton kuptimin e përgjithshëm se korrupsioni nuk kryhet vetëm për avantazh personal për vete por edhe për çfarëdolloj avantazhi apo përfitimi privat, duke përfshirë këtu përfitimin për familjen, kushërinjtë, shokë ose persona apo organizata me të cilat janë vendosur lidhjet e biznesit apo ato politike. Përkufizimi i dhënë përfshin si korrupsionin politik (atë të nivelit të lartë) ashtu dhe korrupsionin administrativ (atë të nivelit më të ulët).

vi. Karakteristikat kryesore të strategjisë

Strategjia aktuale është e përpiluar si një dokument gjithëpërfshirës dhe koherent, i cili vendos objektivat e politikave kundër korrupsionit për Kosovën duke filluar nga viti 2009 deri më 2011. Në lidhje me gjendjen aktuale të reformave kundër korrupsionit dhe rezultateve të zbatimit të Strategjisë kundër Korrupsionit 2004, strategjia prezente fokusohet më tepër në fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe masave praktike/administrative për zbatimin e tyre si dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit tashmë të miratuar, sesa në iniciativa të reja legjislative. Aty ky iniciativat legjislative janë të planifikuara, ato duhet të mbështeten nga masa organizative që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe trajnime për zbatimin e tyre.

Në kuadrin e kësaj strategjie do të zhvillohet një plan veprimi specifik dhe i detajuar. Për këtë qëllim, strategjia parashton qëllime të qarta dhe realiste të cilat do të realizohen përmes masave konkrete legjislative, institucionale dhe organizative siç do të paraqiten në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit.

Në mënyrë që ta prekim sa më shumë problemin e kudo ndodhur të korrupsionit në Kosovë, strategjia synon të përfshijë sa më shumë institucione si të sektorit publik dhe atij privat në përpilimin dhe zbatimin e saj. Qasja gjithëpërfshirëse që përkufizon politikën kundër korrupsionit kërkon që objektivat strategjike të mbulojnë të gjithë sistemin e shoqërisë, duke filluar nga legjislativi, ekzekutivi, gjyqësori e deri tek sektori privat, mediat dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile.

Përveç kësaj, objektivat e strategjisë janë përzgjedhur në mënyrë të tillë që krijojnë balancën midis qasjes së parandalimit dhe qasjes së ndëshkimit, çka do të thotë se strategjia është e fokusuar në objektiva që kanë lidhje me aspektin parandalues, si rritja e ndërgjegjësimit, integritetit dhe transparencës, në mënyrë që të minimizohen praktikët korruptive, por që gjithsesi adreson dhe çështjen e kapaciteteve të zbulimit dhe hetimit të korrupsionit.

Strategjia ka pasur parasysh gjendjen aktuale në Kosovë, duke përfshirë këtu statusin e ri politik dhe ndërkombëtar, faktin se vendi është ende në fazën e tranzicionit si dhe

problemet ekzistuese sociale e karakteristikat kulturore. Për më tepër është bazuar në analizën e tipologjive dhe sektorëve më të prekur nga korrupsioni.

Ky dokument i është përshtatur specifikave të vendit, duke marrë në konsideratë mjetet që janë në dispozicion si dhe është realiste për sa i përket burimeve dhe kapaciteteve që janë të nevojshme për zbatimin e saj. Hartimi i prioriteteve në formën e objektivave synon gjithashtu sigurimin dhe përdorimin sa më optimal të burimeve dhe kapaciteteve që do të duhen për zbatimin e strategjisë.

Kapitulli I. Parimet

Parimet e mëposhtme të demokracisë kanë lidhje direkte më zbatimin e politikave kundër korrupsionit.

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të promovohen dhe respektohen duke përfshirë lirinë dhe sigurinë, të drejtën për zgjedhje të lira, të drejtën e mendimit, të drejtën e shprehjes dhe të drejtën e organizimit në parti dhe shoqata.

Qeverisja e mirë nënkupton një ndarje të qartë midis interesit publik dhe atij personal. Personat që janë të veshur me autoritet publik nuk duhet ta keqpërdorin për përfitim personal të çfarëdo lloji. Ata duhet të deklarojnë çdo konflikt interesi të mundshëm apo ekzistues. Në përgjithësi, institucionet publike duhet të qeverisin me synimin e mirëqenies së përbashkët dhe jo për interes personal apo të një grupi personash.

Shteti i së drejtës do të thotë se asnjëri nuk është mbi ligjin dhe se çdokush duhet të trajtohet si i barabartë para ligjit. Sipas të njëjtit parim, çdokush ka qasje të barabartë në drejtësi.

Qasja në informacion nënkupton faktin se autoritetet shtetërore, përveç qasjes në informacion i cili është i ndaluar me ligj, duhet t'i japin publikut informacionin e kërkuar mbi aktivitetet e kryera prej tyre. Autoritetet shtetërore ndërmarrin masat e duhura në mënyrë që t'i mundësojnë individëve, medias dhe insititucioneve të shoqërisë civile informacionin mbi funksionimin e autoriteteve shtetërore.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parime të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Personat të cilët kanë pozita publike, nëse janë të zgjedhur apo jo të zgjedhur, duhet të japin llogari publikut. Parimi i transparencës aplikohet në rastet e vendimarrjes dhe pasurive të personave që kanë pozita publike, por edhe në rastet e partive politike dhe burimeve të financimit të tyre. Si llogaridhënia ashtu dhe transparenca kanë si kusht lirinë e shprehjes dhe median e pavarur.

Bashkëpunimi dhe koherenca, nënkupton një bashkëpunim sa më të ngushtë dhe të frytshëm të të gjitha institucioneve që kanë për mision apo janë të përfshira në identifikimin, parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Partneriteti publik dhe privat, ky parim njeh rëndësinë e përfshirjes së shoqërisë civile në aktivitete konkrete të zbatimit të masave për parandalimin e korrupsionit.

Kapitulli II. Objektivat e Përgjithshëm të Strategjisë

Në mënyrë që të reflektojë qasjen gjithëpërfshirëse dhe natyrën e masave shumëdimensionale, objektivi i përgjithshëm i Strategjisë është parandalimi dhe luftimi i korrupsionit në sektorin publik dhe privat. Kjo arrihet përmes:

- rritjes së integritetit, llogaridhënies dhe transparencës së legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, forcimin e bashkëpunimit midis këtyre institucioneve si dhe forcimin e kapaciteteve anti-korrupsion të institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal;
- krijimit të kushteve për një ekonomi të çliruar nga praktikat korruptive dhe minimizimin e mundësive korruptive në ekonomi;
- rritjes së rolit të shoqërisë civile dhe rritjes së pjesëmarrjes dhe mbikëqyrjes së procesit nga ana e publikut;
- sigurimin e zbatimit të ligjit përmes aprovimit dhe zbatimit të duhur të kuadrit ligjor anti-korrupsion dhe çështjeve të tjera që lidhen me të; dhe
- zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e parandalimit dhe luftën kundër korrupsionit.

Kapitulli III. Sektorët Prioritarë dhe Objektivat Specifikë

i. Sektori Politik

Informacion i përgjithshëm

Studimet e realizuara gjatë vitit 2007 tregojnë se në Kosovë partitë politike dhe Kuvendi janë të perceptuara nga publiku si sektorët më të prekur nga korrupsioni.¹⁰ Korrupsioni politik apo ai i nivelit të lartë duhet të jetë një fushë prioritare, ku duhet të fokusohen përpjekje të rëndësishme anti-korrupsion.

Objektivat specifikë dhe strategjikë në sektorin politik janë:

- ngritja e integritetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës së pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv të qeverisjes politike,
- ngritja e nivelit të integritetit të parlamentarëve, të cilët do të inkurajojnë procesin e ndërmarrjes së politikave të qëndrueshme anti-korrupsion;
- rritja e kapaciteteve institucionale dhe zbatimit efikas të legjislacionit përkatës do të sigurojë transparencën në vendimarrje dhe të pasurive të personave që kanë detyra publike, të partive politike dhe burimeve të financimit të tyre si dhe financimin të fushatave elektorale;
- rritja e transparencës për emërimet në postet publike.

¹⁰ Raport i Transparencës Ndërkombëtare, Barometri Global i Korrupsionit 2007.

Në mënyrë që të arrihen objektivat e sipërpërmendura, masa legislative dhe institucionale duhen zbatuar me qëllim të ngritjes së mekanizmave të qëndrueshëm për kontrollin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive politike.

Masat anti-korrupsion të sektorit politik do t'iu adresohen:

- (a) partive politike;
- (b) deputetëve të Kuvendit/ legjislativit;
- (c) anëtarëve të qeverisë dhe anëtarëve të kabineteve politike.

ii. Qeverisja lokale

Informacion i përgjithshëm

Në prespektivën e Raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2007 të Komisionit Evropian, niveli i efektivitetit në qeverisjen lokale ka mbetur i dobët. Po sipas këtij raporti, ndarja e përgjegjësive në mes të nivelit qendror dhe atij lokal duhet të përcaktohet më mirë.

Vlerësimi që ka bërë organizata "Freedom House" për progresin në fushën e qeverisjes demokratike të pushtetit lokal në Kosovë qëndron i pandryshueshëm nga viti 2004 deri më 2008 - afër nivelit me të ulët.

Përmirësimi i kapaciteteve të administratës lokale në ofrimin e shërbimeve në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe efikase është një nga prioritetet sipas dokumentit të Partneritetit Evropian 2008.

Mungesa e kontrollit ndaj ndërtimeve të paligjshme është një nga problemet më serioze, ndërsa duhet të përmirësohet zbatimi i rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore.¹¹

Objektivat specifike të këtij sektori janë:

- sigurimi i cilësisë së shërbimeve publike dhe bërja e tyre transparente nga ana e qeverisjes lokale;
- pjesëmarrja e gjerë e publikut në procesin e vendim-marrjes,
- sigurimi i integritetit, llogaridhënies dhe transparencës së duhur nga ana e organeve të qeverisjes lokale;
- ngritja e kapaciteteve administrative të qeverisjes lokale;
- bashkëpunimi me qeverisjen qendrore i bazuar në ndarjen e qartë të përgjegjësive, duke respektuar kuadrin ligjor.

Masat anti-korrupsion në këtë sektor do t'iu adresohen:

- (a) Organeve të qeverisjes lokale;
- (b) Kryetarëve të komunave dhe administratës së qeverisjes lokale.

¹¹ Raporti i Nr 19 i UNDP-së për Paralajmërimin e Hershëm

iii. Administrata publike qendrore

Informacion i përgjithshëm

Megjithë masat e ndërmarra normative dhe institucionale në sektorin e administratës publike, zbatimi i Strategjisë për Reformën në Administratën Publike 2006-2011, nëpunës civilë në Kosovë janë ende të prekur nga ndërhyrjet politike, praktikat korruptive dhe nepotizmi¹². Sipas këtij raporti, probleme të shumta hasen me mosfunksionimin e duhur të Këshillit për Emërimet e Larta, Këshillit të Pavarur Mbikqyrës si dhe moszbatimin adekuat të Kodit të Mirësjelljes. Sipas asaj që u tha më sipër, sigurimi i një shërbimi civil profesional, të paanshëm dhe të përgjegjshëm duhet të jetë një nga prioritetet e Strategjisë kundër Korrupsionit.

Qeveria duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë shmangies së nepotizmit. Aktualisht, lidhjet familjare, përkatësisë politike dhe ryshteti (mitoja) janë faktorët kryesorë për punësim në sektorin publik. Edukimi dhe eksperiencia profesionale nuk shihet si faktorët themelorë për punësim në agjencitë e sektorit publik.¹³ Për shkak të arsyeve të përmendura, zbatimi rigoroz i procedurave transparente për rekrutimin, transferimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, sjelljen dhe heqjen nga puna të shërbyesve civilë është përcaktuar si një prioritet afatshkurtër për Kosovën sipas dokumentit të Partneritetit Evropian për vitin 2008.

Një prioritet tjetër i Partneritetit Evropian ka të bëjë me fushën e standardeve evropiane në rritjen e kapaciteteve administrative të shërbimeve tatimore dhe doganore për të zbatuar ligjin dhe luftuar korrupsionin, krimin ndërkufitar dhe evazionin me taksat.

Përveç këtyre, duhet pasur parasysh se shërbimi mjekësor është perceptuar si një nga sektorët më të prekur në Kosovë¹⁴, ndërkohë që sistemi arsimor shihet si më pak i prekur por që gjithsesi çështje shqetësuese ngrihen dhe për këtë sektor.¹⁵

Objektivat specifikë të administratës publike qendrore janë:

- zhvillimi i një administrate publike profesionale, efikase dhe të paanshme si dhe krijimi i kushteve për parandalimin e favorizimit dhe nepotizmit;
- ngritja e integritetit, përgjegjësisë, transparencës dhe paanshmërisë të administratës publike; dhe
- identifikimi dhe zbatimi i masave specifike anti-korrupsion në sektorët më të prekur të administratës publike qendrore.

Me qëllim të zbatimit të këtyre objektivave specifikë masat specifike anti-korrupsion do t'iu adresohen sektorëve të mëposhtëm:

(a) administratës tatimore;

¹² Raporti i Progresit nga Komisionit Evropian, për vitin 2007 dhe Raporti i Progresit për vitin 2008.

¹³ Raporti i Nr 19 i UNDP-së për Paralajmërimin e Hershëm

¹⁴ Raporti i Nr 20/21 i UNDP-së për Paralajmërimin e Hershëm.

¹⁵ Raport i Transparencës Ndërkombëtare, Barometri Global i Korrupsionit 2007.

- (b) sektorit shëndetësor;
- (c) sektorit të edukimit; dhe
- (d) shërbimeve publike.

iv. Agjencitë Monitoruese, të zbatimit të ligjit dhe gjyqësori

Informacion i përgjithshëm

Forcimi i agjencive monitoruese, atyre të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit është parë si një prioritet gjatë periudhës që ka mbuluar strategjia e kaluar. Kodi Penal i Përkohshëm dhe Kodi i Procedurave Penale i Përkohshëm kanë krijuar kuadrin e duhur për ndjekjen e veprave të korrupsionit. Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit vepron mbi bazën e Ligjit kundër Korrupsionit të miratuar në vitin 2005. Institucionet e tjera monitoruese të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit janë krijuar tashmë: Qendra e Inteligjencës Financiare, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe Ombudspersoni. Policia e Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Publik, të cilët merren me çështjet e ndjekjes dhe hetimit penal të korrupsionit janë ngritur. Nga renditja e korrupsionit e bërë më 2007 nga "Freedom House", shihet se falë disa aktiviteteve anti-korrupsion të kryera dhe sukseseve të arritura, renditja është përmirësuar disi.

Megjithatë çështje shqetësuese janë ngritur mbi garancitë për pavarësinë e AKK-së ndaj presionit politik dhe çështjes.¹⁶ Në vitin 2008 u miratua ligji për konfliktin e interesave, ndërsa është në proces shqyrtimi ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë. Pas miratimit përfundimtar të këtyre dy ligjeve do të ishte mirë që të amandamentohet ligji kundër korrupsionit në mënyrë që të gjitha shqetësimet dhe rekomandimet ti adresohen kuadrin ligjor kundër korrupsionit.

Forcimi i kapaciteteve hetuese të policisë dhe atyre të kontrollit të brendshëm janë konsideruar si tepër prioritare sipas dokumentit të Partneritetit Evropian. Një tjetër prioritet i rëndësishëm është forcimi i Zyrës së Prokurorit Publik për të siguruar përputhshmërinë me parimet e autonomisë dhe paanshmërisë. Edukimi dhe trajnimi i veçantë mbi çështjet e anti-korrupsionit duhet zhvilluar nga Instituti Gjyqësor për prokurorët dhe gjyqtarët. Për më tepër, një sistem për emërimin, shkarkimin dhe ngritjen në karrierë të prokurorëve dhe gjyqtarëve pritet të zbatohet pa pasur ndërhyrje politike apo ndërhyrje të tjera të papërshtatshme.

Sipas raportit të ABA CEELI-t për vitin 2007 mbi "Indeksin e Reformës Gjyqësore për Kosovë", gjyqësori nuk ka qenë subjekt i ndonjë presioni të rëndësishëm nga jashtë të shkaktuar nga interesat politike apo degë të tjera të qeverisë. Por gjithsesi Gjyqësori mbetet subjekt për presion nga ana e interesave private.

Objektivat specifike të këtij sektori janë:

¹⁶ Raporti i Progresit nga Komisionit Evropian, për vitin 2007 dhe Raporti i Progresit për vitin 2008.

- fuqizimi i institucioneve përgjegjëse për zbulimin, hetimin dhe ndërkimimin e korrupsionit;
- sigurimi i pavarësisë, autonomisë, llogaridhënies dhe paanshmërisë, respektivisht organeve të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjykatave; dhe
- parandalimi dhe luftimi i korrupsionit brenda institucioneve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit.

Masat për rritjen e integritetit dhe kapaciteteve specifike do t'iu adresohen:

- (a) Agjencionit Kosovari kundër Korrupsionit;
- (b) Ombudspersonit;
- (c) Auditorit Gjeneral;
- (d) Qendrës së Inteligjencës Financiare;
- (e) Policisë së Kosovës dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit që kanë pushtet investigativ;
- (f) Zyrës së Prokurorit Publik dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (g) Gjykatave dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- (h) Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë.

v. Financat Publike dhe Menaxhimi i Tyre

Informacion i përgjithshëm

Gjatë vitit 2007, është raportuar për progres në fushën e kontrollit financiar të brendshëm publik, ndërsa sa i përket kontrollit të jashtëm Zyra e Auditorit Gjeneral ka pushtet të rezervuar në këtë fushë.¹⁷ Një nga prioritetet e caktuara në Dokumentin e Partneritetit Evropian 2008 është edhe zhvillimi dhe zbatimi i parimeve të përgjegjësisë manaxheriale të decentralizuar dhe funksionimi i pavarur i kontrollit të brendshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira evropiane, përmes një legjislacioni bashkëkohor dhe kapaciteteve administrative të duhura. Një prioritet tjetër është fuqizimi i kapaciteteve operationale si dhe pavarësia operationale dhe financiare e Institucionit të Kontrollit të Lartë.

Gjithashtu, theksohet se në vazhden e reformave, përpjekjet duhet përqëndruar në krijimin e një kuadri institucional për prokurimin publik me kapacitete administrative dhe pavarësi të siguruar, në mënyrë që të kryejë misionin e tij.

Objektivat specifike të sektorit të financave publike dhe menaxhimit të tyre janë:

- fuqizimi i integritetit dhe forcimi i transparencës kur shpenzohet dhe menaxhohet pasuria publike, duke përfshirë këtu fondet të cilat vijnë/jepen nga institucione financiare ose donatorë ndërkombëtarë;
- zhvillimi dhe zbatimi i masave anti-korrupsion që kanë për qëllim eliminimin e keqpërdorimit të parasë publike dhe rritjen e nivelit të mirëqënies sociale;

¹⁷ Raporti i Progresit nga Komisionit Evropian, për vitin 2007

- zhvillimi dhe zbatimi i masave anti-korrupsion që kanë për qëllim rritjen e besimit të publikut në veprimet me parandë publike.

Institucionet specifike ndaj të cilave adresohen masat për rritjen e transparencës dhe kapaciteteve janë:

- (a) Organet e prokurimit publike
- (b) Zyra e Auditorit Gjeneral;
- (c) Banka Qendrore;
- (d) Kompanitë në pronësi të shtetit;
- (e) Agjensia Kosovare e Pronave;
- (f) Doganat;
- (g) Administrata tatimore.

vi. Sektori privat/Veprimet e biznesit

Informacion i përgjithshëm

Është vënë re një progres i vogël në fushën e politikave të konkurrencës lojale. Komisioni i Konkurrencës është ende në proces të konsolidimi. Ligji për rezervat shtetërore ende nuk është miratuar.¹⁸ Problemet serioze të cilat kërkojnë një vëmendje të vecantë lidhen me ekonominë informale dhe kapacitetet e pamjaftueshme të qeverisë për të monitoruar këtë lloj ekonomie, sidomos përsa i përket çështjeve të ndërtimeve dhe marrjes me qera.¹⁹

Objektivat specifike të sektorit privat janë:

- sigurimi i rregullave të qarta dhe transparente për kryerjen e aktiviteteve të biznesit;
- promovimi i konkurrencës lojale;
- zhvillimi dhe zbatimi i praktikave të drejta dhe etike në biznes; dhe
- fuqizimi i rolit të ndërgjegjësimit mbi rolin e biznesit dhe organizatave profesionale.

Masat kanë për qëllim rritjen e transparencës dhe etikës në sektorin e biznesit dhe u adresohen:

- (a) Kompanive të sektorit privat;
- (b) Shoqatave të Biznesit/Dhomës së Tregtisë;
- (c) Sindikatave.

¹⁸ Raporti i Progresit nga Komisionit Evropian, për vitin 2007

¹⁹ Raporti i Nr 19 i UNDP-së për Paralajmërimin e Hershëm

vii. Shoqëria civile

Informacion i përgjithshëm

Sipas raportit të Freedom House, grupet e shoqërisë civile kanë qenë aktive në marrjen e iniciativave në fushën e anti-korrupsionit. Kjo është arritur përmes monitorimit të aktiviteteve të qeverisë dhe zbatimit të ligjeve (sidomos të Ligjit për Qasjen në Dokumentet Zyrtare), në përputhshmëri me respektimin e të drejtave të njeriut.

Reforma në media po ecën përpara, por problemet kryesore si dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes si dhe zbatimi i duhur i legjislacionit mbi të drejtën e informimit kanë ende nevojë të plotësohen.²⁰

Objektivat specifike të sektorit të shoqërisë civile janë:

- rritja e mbikëqyrjes nga ana e shoqërisë civile;
- fuqizimi i OJQ-ve në angazhimin e tyre në përpjekjet e përbashkëta anti-korrupsion duke i parë si faktor kyç në proces;
- sigurimi i funksionimit të mediave të pavaruara dhe hulumtuese;
- ngritja e ndërgjegjësimit të publikut; si dhe
- rritja e edukimit në luftën kundër korrupsionit me qëllim të rritjes së rezistencës së publikut ndaj fenomeneve korruptive.

Masat që kanë për qëllim arritjen e objektivave të mësipërm duhet të zbatohen nga:

- (a) autoritetet publike;
- (b) organizatat joqeveritare dhe mediat;
- (c) sindikatat.

Kapitulli IV. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Lufta efektive kundër korrupsionit kërkon një bashkëpunim ndërkombëtar që rritet, zhvillohet shpejt dhe që funksionon mirë. Pas shpalljes së pavarësisë të vendit, nevoja për përgatitjen për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare dhe aderimin në standardet ligjore ndërkombëtare dhe mekanizmat monitorues anti-korrupsion duhet të konsiderohet një prioritet.

Zotimet e ardhshme ndërkombëtare kërkojnë si parakusht një analizë të nivelit të harmonizimit të legjislacionin vendas dhe praktikave me standardet evropiane në fushën e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, duke përfshirë standardet e vendosura nga konventat, rekomandimet dhe aktet ligjore ndërkombëtare kundër

²⁰ Raporti i Progresit nga Komisionit Evropian, për vitin 2007

korrupsionit të miratuara nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës dhe Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD-ja).

Një kujdes i vecantë duhet treguar për të siguruar përputhshmërinë me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), e cila derimë tani është standardi më i njohur universalisht në luftën kundër korrupsionit. Në këtë kontekst, asistenca teknike dhe e specializuar e dhënë përmes projekteve të ndryshme ndërkombëtare duhet përdorur në mënyrë sa më efikase.

Përpjekjet duhen fokusuar në përgatitjen për ratifikimin e zbatimin e ardhshëm të konventave të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit dhe konventat që kanë lidhje me fushën penale: Konventa Penale e Korrupsionit dhe Protokolli Shtesë i saj, Konventa Civile e Korrupsionit si dhe konventat për ekstradimin, asistencën e ndërsjelltë ligjore, transferimin e personave të dënuar dhe transferimin e procedimeve penale.

Pjesëmarrja në mekanizmat ndërkombëtarë të krijuar për monitorimin e harmonizimin me aktivitetet e kryera në fushën kundër korrupsionit është thelbësore për përmirësimin e kapaciteteve të autoriteve kompetente vendore për luftimin e korrupsionit. Përsa i përket kësaj, hapat të menjëhershëm duhen ndërmarrë që Kosova të bëhet anëtare e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO). Gjithashtu masa duhen ndërmarrë për zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit me autoritetet shtetërore të përfshira në luftimin e korrupsionit, përkatësisht me organizatat dhe rrjetet ndërkombëtare që operojnë në këtë fushë.

Masat të cilat duhen zbatuar në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar kanë për qëllim krijimin e kushteve për pjesëmarrje në instrumentat e lartpërmendur, si dhe për të forcuar bashkëpunimin bilateral dhe multilateral në rajon e më gjerë. Gjithashtu, masat e parashikuara do të koordinohen nga Qeveria e Kosovës dhe do të zbatohen nga Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit dhe agjencitë e tjera kompetente si agjensitë monitoruese, organet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori.

Kapitulli V. Miratimi, Monitorimi dhe Zbatimi i Strategjisë

Strategjia e re kundër Korrupsionit përbën dokumentin themelor të politikave anti-korrupsion dhe do të zbatohet gjatë periudhës kohore 2009 -2011²¹. Pasi strategjia të kalojë në procesin e përpilimit dhe të finalizimit, Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit ia dorëzon këtë dokument për aprovim Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila pas shqyrtimit ia kalon Kuvendit të Kosovës për miratim.

Pas miratimit përfundimtar të Strategjisë kundër Korrupsionit 2009 - 2011, dhe në mënyrë që të procedohet me zbatimin e saj, Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Zyrën për Qeverisje të Mirë, është organi i ngarkuar, i cili në bashkëkoordinim me institucionet e tjera, do të fillojë procesin e përpilimit të Planit të Veprimit përkatës, i cili do të shtrihet

²¹ Raporti i Progresit nga Komisionit Evropian, për vitin 2008

në të njëjtën periudhë kohore 2009 - 2011. Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit është përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e masave të parapara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit.

Në përputhje me objektivat specifike, të përcaktuar sipas çdo sektori prioritar të Strategjisë kundër Korrupsionit, Plani i Veprimit do të reflektojë dhe përcaktojë masat specifike dhe konkrete për secilin institucion përgjegjës, së bashku me tregues suksesi të prekshëm dhe periudhë kohore të qartë dhe realiste. Me qëllim zbatimin dhe realizimin e masave të parapara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit, do të llogaritet implikimi financiar për çdo masë dhe mbështetja e duhur financiare duhet të jepet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Masat e Planit të Veprimit kundër Korrupsionit do të grupohen sipas tre kategorive: a) masa legjislative; b) masa institucionale; dhe c) masa praktike/administrative/organizative.

Së fundmi, Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit është organi përgjegjës, i cili raporton mbi zbatimin e përgjithshëm të Strategjisë kundër Korrupsionit. Në lidhje me këtë, Agjensioni i raporton direkt Kuvendit të Kosovës në raportin e tij vjetor.

Plani i Veprimit kundër Korrupsionit

2009-2011

I. HYRJE

Në një shtet të ri dhe demokratik, sundimi i ligjit, shtetit të së drejtës dhe mirëqenies social duhet të jenë shtyllat kryesore mbështetëse. Qeveria e Republikës së Kosovës, ka shpallur si një ndër prioritetet e saj kryesore tolerancën zero ndaj korrupsionit. Kjo iniciativë synon në rritjen e besimit të publikut ndaj institucioneve, ndërtimin e një administratë profesionale dhe etike, hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe dokumenteve të politikave përkatëse në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, parandalimin dhe luftimin e dukurive që rrjedhin nga korrupsioni për të realizuar zhvillimin e përgjithshëm ekonomik-social dhe arritjen e standardeve për integrimin evropian.

Për të vënë në zbatim këtë vullnet të shprehur qartë politikisht, dokumenti i Strategjisë kundër Korrupsionit 2009 -2011 i hartuar nga Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit në bashkëpunim me institucionet vendore, dhe i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në datën _____ paraqet objektiva dhe prioritete të qarta që dalin përpara institucioneve përgjegjëse të të gjitha niveleve, ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit për parandalimin dhe luftimin e dukurive negative dhe të dëmshme që rrjedhin nga korrupsioni.

II. HISTORIKU

Plani i parë i Veprimit kundër Korrupsionit i cili vinte në zbatim Strategjinë kundër Korrupsionit të aprovuar në 2004 u hartua dhe u zbatua vetëm për periudhën kohore 2005 - 2007. Ky dokument ishte një plan gjithëpërfshirës që përmbante shumë masa të kategorizuar nën këto fusha:

- a) Masa specifike anti-korrupsion;
- b) Masa legjislative anti-korrupsion;
- c) Masat gjyqësore dhe zbatimi i ligjit;
- d) Masat e reformimit të administratës publike;
- e) Masat në fushën e financave publike dhe ekonomisë;
- f) Mediat, shoqëria civile dhe pjesëmarrja e publikut;
- g) Masat në ngritjen e kapaciteteve dhe edukim; dhe
- h) Masat e tjera të reformës institucionale.

Duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga praktika e monitorimit dhe zbatimit të planit të kaluar të veprimeve, plani i ri paraqet në mënyrë sa më konkrete të qartë, dhe më një qasje koherente prioritetet dhe masat që duhen ndërmarrë në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë.

Në zbatim të Strategjisë kundër Korrupsionit 2009-2011, Plani i Veprimit është një dokument vizionar i cili paraqet veprime konkrete të matshme dhe me afate kohore të qarta, objektivat specifike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në Kosovë. Si dhe strategjia, plani i veprimit shtrihet në një periudhë kohore trevjeçare. Ai tenton që të

mësojë nga zbatimi dhe boshllëqet e planit paraardhës si dhe të përmirësojë mënyrën e zbatimit të një dokumenti strategjik siç është Strategjia kundër Korrupsionit.

Procesi i hartimit të planit të veprimit u karakterizua nga bashkëpunimi i të gjitha institucioneve përgjegjëse por gjithsesi pati mungesa të theksuara kontributi nga ana e shoqërisë civile dhe sektorit të biznesit. Në këtë kuadër disa takime paraprake përgatitore u organizuan për hartimin e skicë idesë së planit të ri, krijimit të rrjetit të pikave të kontaktit dhe hartimin fillestar të planit të veprimit. Përfshirja e shumë aktorëve dhe harmonizimi i përpjekjeve të tyre, rezultuan në një faktor kyç që determinoi procesin e hartimit të planit të veprimit.

III. STRUKTURA

Struktura e këtij plani veprimesh vjen i ripunuar në krahasim me planin e kaluar të veprimit. Matrica e planit të veprimit 2009 - 2011 është e bazuar në fushat prioritare të parashikuara në Strategjinë kundër Korrupsionit, të cilat parashikojnë veprime specifike dhe konkrete anti-korrupsion përkatësisht në tetë fusha:

- Sektori politik;
- Qeverisja lokale;
- Administrata publike qendrore;
- Agjencitë monitoruese, të zbatimit të ligjit dhe gjyqësori;
- Financat publike dhe menaxhimi i tyre;
- Sektori privat dhe veprimet e biznesit;
- Shoqëria civile (edukimi dhe pjesëmarrja e publikut);
- Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Një risi në këtë plan veprimi është së veprimet e paraqitura në matricë do të jenë zbatimi në praktikë i objektivave të veçanta për një veprim apo grup veprimesh, objektiva të cilët do të zbërthejnë më detajisht objektivat specifike të paraparë sipas çdo sektori prioritar në strategji.

Gjithashtu për të lehtësuar çështjen e paraqitjes sa më të përafërt të kostos monetare të çdo veprimi, kolona e buxhetit paraqitet me dy opsione dhe shprehet me fjale dhe jo me vlerë monetare: nëse veprimi është i paraparë në linjat buxhetore vjetore të institucionit dhe/ose është i paraparë të jepet në formë donacioni apo asistence teknike nga projekte apo organizata të ndryshme.

Natyra e veprimeve të parapara në këtë plan veprimesh janë kryesisht të kategorizuara në:

- Veprime për zbatimin e ligjit;
- Veprime parandaluese; dhe
- Veprime për edukimin dhe pjesëmarrjen e publikut.

Duhet pasur parasysh se ky plan veprimesh përveç se përfshin institucione të pavarura si Prokuroria e Shtetit të Kosovës, Ombduspersoni, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, shoqëria civile etj, simbolizon dokumentin e programeve, përpjekjeve dhe iniciativave

anti-korrupsion që këto institucione planifikojnë apo mendojnë të ndërmarrin në tre vitet e ardhshme. Për më tepër, bën të mundur ndërthurjen dhe përpiqet të shmangi mbivendosjet e veprimeve/masave anti-korrupsion në dokumente apo plane të tjera veprimesh që kanë lidhje me reforma të ndryshme si p.sh. reforma në administratën publike, procesi i integritit evropian, etj.

IV. MONITORIMI DHE ZBATIMI

Monitorimi i zbatimit të këtij plani veprimi kryhet nga Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit. AKK-ja është struktura e cila përgjigjet për përcjelljen, koordinimin dhe raportimin mbi zbatimin e Planit të Veprimit. Agjencia përpos monitorimit të zbatimit të veprimeve nga ana e institucioneve, është përgjegjës dhe për zbatimin e veprimeve të parashikuara nga vetë ajo në matricë.

Institucionet përgjegjëse të parapara në këtë plan veprimi janë direkt përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin e veprimeve përkatëse. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e veprimeve i raportojnë rregullisht AKK-së një herë në tre muaj mbi ecurinë e veprimeve. Kurdo e shih të nevojshme për një grup veprimesh apo ndonjë institucion të veçantë, AKK-ja ka të drejtën të kërkojë raportimin në baza mujore apo vetëm për një veprim të caktuar.

Ura lidhëse për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit ndërmjet AKK-së dhe institucioneve përgjegjëse janë pikat e kontaktit. Monitorimi i planit të veprimit dhe ecuria e veprimeve të tij do të paraqiten një herë në vit në formën e një raporti arritjesh. Raporti i arritjeve duhet të përpilohet dhe finalizohet nga AKK-ja deri në datën 31 mars të çdo viti pasardhës.

Plani i Veprimit është një dokument dinamik dhe ka nevojë të rishikohet. Procesi i rishikimit të Planit të Veprimit kryhet nga Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit në fund të çdo viti kalendarik dhe me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve përgjegjëse.

V. MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT 2009-2011

Nr	Objektivat	Veprimet	Institucionet përgjegjëse/ bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesit e suksesit	Buxheti	
						Paraparë në buxhet	Paraparë nga donacionet/a sistenca teknike
I. Sektori Politik							
I. 1	Plotësimi i infrastrukturës ligjore për pagesat e funksionarëve publikë	1. Përgatitja e projektligjit për pagat e funksionarëve publikë	MSHP, MD, MEF, MAPL, ZKM, KGJ, KP, Kuvendi.	Qershor 2009	-Miratimi i ligjit në Kuvendin e Kosovës -Shmangia e mundësisë për abuzim me mjete publike	Po	
		2. Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit	MSHP, Qeveria e Kosovës.	Dhjetor 2009	- Zbatimi i plotë i ligjit	Po	
I. 2	Plotësim i kuadrit ligjor ne lidhje me financimin e partive politike dhe fushata zgjedhore me qellim parandalimin dhe luftimin e korrupsionit ne këto fusha dhe harmonizimin e legjislacionit me standardet evropiane	1. Kryerja e një studimi paraprak për legjislacionin aktual dhe evidentimin e boshllëqeve	ZKM, MD, MEF, KQZ, AKK.	Shtator - Dhjetor 2009	-Realizimi i studimit ne kohen e parapare - Rezultatet e studimit përbejnë bazën përgatitore për përgatitjen e ligjit te veçantë.	Po	
		2. Hartimi i një ligji te veçante për financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore	ZKM, MD, MEF, KQZ, Qeveria, Kuvendi .	Qershor 2010	- Miratimi dhe hyrja e ligjit ne fuqi - Rregullimi i fushës përkatëse dhe parandalimi i keqpërdorimit te fondeve publike -Përgjegjshmëri me e lart nga partitë politike ne marrjen dhe shpenzimin e fondeve dhe sigurimi i transparencës	Po	

					ndaj publikut - Minimizimi i abuzimeve gjate fushatave elektorale		
		3. Hartimi i një manuali për zbatimin e kuadrit ligjor	ZKM/ZL MD, AKK.	Shtator 2010	- Nxjerrja dhe miratimi i legjislacionit dytësor - Hartimi dhe vënia në zbatim i manualit	Jo	
II. Qeverisja Lokale							
II. 1	Ngritja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të administratës së qeverisjes lokale	1. Trajnime profesionale te administratës lokale ne qellim rritjen e eficences se shërbimeve ndaj publikut	KK, AK, MAPL, MSHP. ZKM/ZQM	Në vazhdimësi	- Raportime më cilësore si nga përmbajtja dhe nga forma; - Administrim me profesional dhe efektiv i shërbimeve ndaj publikut -Zvogëlimi i vonesave në dorëzimin e raporteve. - Rritja e cilësisë dhe ngritja e efikasitetit ne ofrimin e shërbimeve për qytetaret - Minimizimi i fenomeneve korruptive për një administrate lokale me integritet te larte	Po	Projekt i USAID
II. 2	Sigurimi i integritetit, ngritja e llogaridhënies dhe transparencës nga ana e organeve komunale	1. Zbatimi i duhur i rregulloreve komunale për transparencën.	KK, AK, MAPL.	Dhjetor 2009	- Ngritja më e lartë e vetëdijes së popullatës në lidhje me proceset e qeverisjes lokale, detyrat e tyre dhe llogaridhënien	Po	
		2. Publikimi i dokumenteve veçmas të Komitetit për Politikë dhe Financa, zyra të prokurimit dhe zyrës së kryetarit në webfaqet dhe panot komunale	KK, AK, Shoqëria civile, Asociacioni i biznesit.	N vazhdimësi	- Hartimi i politikave dhe proceset e vendimmarrjes mbi shpenzimet e parasë publike bëhen përmes proceseve transparente - Mënjanimi i rasteve te konfliktit te interesit dhe formave te tjera te abuzimit me postet publike	Po	

		3. Mirëfunksionimi i zyrave te marrëdhënieve me publikun	KK, AK.	Në vazhdimësi	- Shërbime me te mira dhe ne kohe ndaj publikut - Publiku është i mirinformuar dhe mënjanohe mundësitë për raste korruptive	Po	
		4. Organizimi i serive te debateve me publikun mbi çështje me interes të përgjithshëm e specifik.	KK, AK, Shoqëria civile, Asociacioni i biznesit.	Ne vazhdimësi	-Marrja e mendimit te publikut dhe grupeve te interesit për çështje qe lidhen me mirëfunksionimin e qeverisjes lokale dhe cilësinë e jetesës - Publiku merr pjese gjerësisht ne vendimmarrje	Jo	
II. 3	Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendim-marrjes në komuna	1. Organizimi i dëgjimeve publike për çështje ligjore apo politikash qe merren nga kuvendet komunale	KK, AK, MAPL, Shoqëria civile, Asociacioni i biznesit.	Në vazhdimësi	- Ngritja e transparencës gjatë vendim - marrjes nga ana e kuvendeve të komunave dhe organeve tjera në marrjen e vendimeve. - Aktet që nxirren nga ana e kuvendeve komunale, duhet të jenë të pranueshme dhe të zbatueshme për qytetarët;	Po	
		2. Organizimi i fushatave vetëdijesuse për nxitjen e pjesëmarrjes se publikut ne procesin e vendimmarrjes.	KK, AK, MAPL, Shoqëria civile, Asociacioni i biznesit.	Në vazhdimësi	- Rritet besimi i qytetarëve ndaj organeve komunale dhe zvogëlohet numri i mundshëm i keqpërdorimeve.	Jo	
II. 4	Harmonizimi i kuadrit ligjor ne fushën e urbanizimit	1. Inicimi dhe hartimi i ligjit për menaxhimin dhe procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronave publike ku do të përfshiheshin edhe shënimet kadastrale	KK, AK, MAPL, Shoqëria civile.	Dhjetor 2009	- Zvogëlimi i kërkesave të adresuara në drejtoritë përkatëse dhe gjykatat komunale sa i përket përcaktimit të njohjes së të drejtës së pronësisë; - Rritja e efikasitetit dhe transparencës së organeve të	Po	

		2. Qartësimi i procedurave administrative në mënyrë që ligji të kuptohet dhe të zbatohet drejtë në sferat e parapara si objektiva me rëndësi. ë	KK, AK, MAPL, Shoqëria civile.	Qershor 2010	komunave. - Inkasimi transparent i të hyrave për shërbimet e kryera në terren dhe në zyre - Zvogëlimi i burokracisë dhe korrupsionit të mundshëm.	Po	
III. Administratë Qendrore Publike							
III. 1	Fuqizimi i sistemit prokurorial për luftimin e korrupsionit në Kosovë	1. Hartimi dhe miratimi i ligjit për Këshillin Prokurorial	MD, Prokuroria, Qeveria, Kuvendi .	Dhjetor 2009	- Puna më efektive e sistemit prokurorial në ndjekjen e rasteve të korrupsionit - Fuqizimi i kapaciteteve të prokurorisë - Ngritja e kontrollit dhe mbikëqyrjes brenda sistemit	Po	
		2. Hartimi dhe miratimi i ligjit për Prokurorinë e Shtetit	MD, Prokuroria, Qeveria, Kuvendi.	Dhjetor 2009	- Puna më efektive e sistemit prokurorial - Qartësimi i kompetencave të prokurorëve sipas sistemit të ri dhe mirëfunksionim me i mirë i sistemit në tërësi	Po	
III. 2	Plotësimi dhe harmonizimi i legjislacionit vendas në fushën e anti-korrupsionit dhe në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane	1. Amendamenti i Kodit Penal të Kosovës	MD, AKK, IGJK, Prokuroria, Qeveria, Kuvendi.	Dhjetor 2010	- Rritja e efikasitetit në dënueshmërinë e korrupsionit Miratimi i paketës ligjore Fuqizimi i kuadrit ligjor për penalizimin e veprave korruptive Rritja e numrit të rasteve të ndjekura dhe të dënuara në vit për kryerjen e veprave korruptive	Po	Projekti SACIK
		2. Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit kundër Korrupsionit	MD, AKK, Qeveria, Kuvendi, Shoqëria civile.	Shtator 2009	-Miratimi i ligjit -Hartimi në kohë i akteve nënligjore -Zbatimi i tij në mënyrën e duhur përmes rezultateve të treguara në raportin vjetor të AKK-se	Po	Projekti SACIK

					-Ndërgjegjësim me i madh i zyrtareve publik për kuadrin ligjor anti-korrupsion dhe vënien ne praktike te tij.		
		3. Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcionit Publik	MD, AKK, Qeveria, Kuvendi, Shoqëria civile.	Shtator 2009	-Miratimi i ligjit - Hartimi ne kohe i akteve nënligjore -Zbatimi i tij ne mënyrën e duhur përmes rezultateve te treguara ne raportin vjetor te AKK-se -Rritja e rasteve te raportuara mbi konfliktin e interesit -Rritja e numrit te rasteve te parandaluara qe përbenin konflikt interesi e dëmtonin paranë publike	Po	Projekti SACIK
		4. Hartimi e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë	MD, AKK, Qeveria, Kuvendi, Shoqëria civile.	Shtator 2009	-Miratimi i ligjit -Hartimi ne kohe i akteve nënligjore -Zbatimi i tij ne mënyrën e duhur përmes rezultateve te treguara ne raportin vjetor te Agjencia -Deklarimi efektiv dhe ne kohe nga ana e zyrtareve qe janë te obliguar -Një ndërgjegjësim me i larte i zyrtareve te larte për përgjegjësinë e tyre ndaj posedimit dhe deklarimit te pasuri -Publikimi i deklarimeve te zyrtareve te larte dhe qasja e lehte e publikut ne to.	Po	Projekti SACIK
III. 3	Rritja e efikasitetit në lëshimin e licencave për Ndërmarrjet ndërtimore.	1. Thjeshtëzimi i formularëve për licencë	MTI	Dhjetor 2009	- Procedura të thjeshta dhe efikase për marrjen e licencave		

		2. Barazimi i te hyrave nga evidencat e regjistruara në DN me Fre balancën,		Në vazhdimësi	- Evidentimi korrekt, brenda ditës, së të gjitha kompanive që kanë aplikuar për licencë - Ulja e mundësive për korrupsion kur procedurat janë të qarta e të thjeshtëzuara	Po	
III. 4	Plotësimi i infrastrukturës ligjore për inspeksionin e tregut	Hartimi dhe miratimi i projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për "Inspeksionin e Tregut"	MTI, Qeveria, Kuvendi.	Dhjetor 2009	- Efektshmëri me e larte e inspektoratit - Eliminimi i praktikave jo te mira ne tregun e Kosovës.	Po	
III. 5	Transparence e plotë në zhvillimin e procedurave të regjistrimit të bizneseve	1. Implementimi i Ligjit mbi shoqëritë nr.02/L-123	MTI, ARBK.	Në vazhdimësi	- Rritja e besimit te qytetarit tek institucionet - Shërbime te mira dhe cilësore e ne kohe te dhëna - Minimizimi i ankesave dhe rasteve për korrupsion ne regjistrimin e bizneseve duke anashkaluar kriteret	Po	Donacion nga Banka Botërore
III. 6	Plotësimi i kuadrit ligjor për shërbimet diplomatike.	1. Hartimi i akteve nënligjore në zbatim te Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Shërbimin Konsullor.	MPJ	Dhjetor 2009	Zbatim të akteve ligjore dhe funksionalizim të shërbimit diplomatik dhe konsullor - Përdorimi i mire dhe i përgjegjshëm i parasë publike ne shërbimet konsullore - Bërja transparente e procedurave ligjore - Qytetaret marrin shërbime te rregullta ne kohe dhe nuk ka vend për veprime korruptive	Po	
III. 7	Ngritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve	1. Futja ne përdorim e një forme te standardizuar qe do t'iu mundësonte qytetareve te paraqesin ankesat e tyre	MIPT	Dhjetor 2009	- Rritja e besimit te publikut tek institucionet qendrore qe ofrojnë shërbime - Ulja e numrit te ankesave me natyre korruptive nga viti ne vit	Po	
		2. Vendosja e kutive anti-korrupsion në departamentet	MIPT	Dhjetor 2009	-Rritje e transparencës dhe ulje e rasteve të	Po	

		përkatëse			keqpërdorimeve		
III. 8	Përcaktimi i saktë i kompetencave të njësive organizative të MTPT-së për lëshimin e licencave dhe lejeve të ndryshme	1. Hartimi i kuadrit përkatës ligjor dhe nënligjor	MTPT	Dhjetor 2009	- Eliminimi i paqartësive dhe mundësive abuzive - Licencimi dhe lejet janë procedura transparente dhe nuk lëne hapësira për fenomene korruptive	Po	
III. 9	Rritja e kapaciteteve njerëzore në kryerjen e shërbimeve për qytetarit	1. Hapja e pikave të reja për qytetarët, ku ata mund të kryejnë shërbimet për marrjen e dokumenteve të ndryshme	MPB, MEF, MSHP, KK	Dhjetor 2010	Rritja e efikasitetit të shërbimeve -Sigurimi i transparencës dhe shërbimi ndaj qytetarit larg korrupsionit në formë të vogla	Po	
III. 10	Digjitalizimi i punëve për regjistrim të automjeteve	1. Krijimi i një baze qendrore për regjistrimin e automjeteve	MPB	Qershor 2010	Lehtësimi në lëshimin e lejeve të automjeteve -Qytetarit i jepen shërbime të mireorganizuarë e që nuk lenë vend për raste korruptive	Jo	
III. 11	Plotësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor në fushën e shërbimit civil për të pasur një administratë etike dhe larg fenomeneve korruptive dhe rritja e transparencës	1. Hartimi dhe Miratimi ligjit për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.021 /-29 për procedurën administrative	MSHP, ZKM/ZQM MD, MAPL, MPB, Këshilli Gjyqësor, Kuvendi.	Shator 2009	- Miratimi i Ligjit, - Administratë me efikasitet dhe në shërbim të qytetarëve	Po	
		2. Nxjerrja e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit	MSHP	Qershor 2010	-Nxjerrja e akteve në kohë e pa zvarritje -Zbatimi i duhur i kuadrit ligjor	Po	
		3. Miratimi i ligjit për shërbimin civil.	MSHP, Qeveria, Kuvendi.	Qershor 2009	-Miratimi i projektligjit, - Rritja e efektivitetit të punës së nëpunësve civil -Minimizimi i rasteve korruptive përfshi këtu dhe konfliktet e interesit, nepotizmin e favorizimin	Po	

		4. Miratimi i Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare	MSHP ZKM, ZQM, AKZHIE, Kuvendi, Presidenca, AKK, Këshilli Gjyqësor, MD, Komisioni i Pavarur për Media , Arkivi i Kosovës, Përfaqësues të Shoqërisë Civile , Komisioni Ndërinstitucional , për Vlerësimin e praktikave Administrative në fushën e dokumenteve Zyrtare.	Dhjetor 2009	- Qasje e lehte e qytetarëve në dokumentet zyrtare, - Rritja e transparencës së institucioneve të administratës publike	Po	
		5. Nxjerrja e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit	MSHP	Qershor 2010	-Nxjerrja e akteve ne kohe e pa zvarritje -Zbatimi i duhur i kuadrit ligjor	Po	
		6. Organizimi i trajnimeve dhe fushatave informuese për zyrtarët dhe qytetarët	MSHP ZKM/ZQM	Në vijim pas hyrjes në fuqi të ligjit	-Ngritja e njohurive për qasje në institucionet e administratës publike -Administrata publike behet me e përgjegjshme për veprimet e saj	Po	
III. 12	Rritja e efikasitetit të hetimeve të rasteve të dyshimta të shpërdorimeve të pozitës zyrtare a po shkeljeve të rregullave të sjelljes brenda ATK-se	1. Shqyrtimi i ankesave të qytetareve	ATK, Gjykata, PK, Agjencitë e tjera.	Në vazhdimësi	- Rritja e besimit të publikut - Rritja e deklarimeve vullnetare	Po	
		2. Hetimi i rasteve të dyshuara	ATK, Gjykata, PK, Agjencitë e tjera.	Në vazhdimësi	- Numri i hetimeve të kryera ne baza vjetore	Po	

		3. Bashkëpunimi i shtuar dhe efikas me organet përkatëse të ndjekjes penale	ATK, Gjykata, PK, Agjencitë e tjera.	Në vazhdimësi	-Numri i rasteve të trajtuara në mënyrë të suksesshme nga ky bashkëpunim - Numri i personave të dënuar	Po	
		4. Marrja e masave disiplinore	ATK, Gjykata, PK, Agjencitë e tjera.	Në vazhdimësi	- Identifikimi dhe marrja e masave disiplinore për të gjithë që kanë dëmtuar BKK - Numri i masave të marra dhe niveli i zbatimit të tyre	Po	
III. 13	Krijimi dhe zhvillimi i mekanizmave adekuat për hetimin dhe parandalimin e korrupsionit në ATK	1. Zhvillimi i ZSP-se	ATK	Në vazhdimësi	-Efektshmëri me e lartë në punë dhe zbatimin e detyrave	Po	
		2. Themelimi dhe zhvillimi i njësisë për kualitet të kontrolleve	ATK	Në vazhdimësi	-Specializim profesional në kryerjen e detyrave	Po	
		3. Nxjerrja e akteve nënligjore	ATK MEF	Dhjetor 2009	-Zbatimi i duhur i kuadrit ligjor dhe rezultatet e arritura	Po	
III. 14	Shtimi i masave për parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve të këqija në administratën tatimore të Kosovës	1. Organizimi i trajnimeve kundër korrupsionit	ATK, IKAP, Etj.	Ne vazhdimësi	-Ngritja profesionale dhe e ndërgjegjësimit	Po	
		2. Organizimi i trajnimeve lidhur me kodin e mirësjelljes	ATK	Ne vazhdimësi	-Nëpunësit doganor kryejnë detyrat në mënyrë etike dhe profesionale dhe nuk ka raste korruptive	Po	
		3. Njohja me rregullat e sjelljes në ATK	ATK	Ne vazhdimësi	-Minimizimi i rasteve të konfliktit të interesit, nepotizmit e favorizimit	Po	
III. 15	Rritja e komunikimit me publikun dhe transparencës në ATK	1. Prezantimi i rezultateve të arritura	ATK	Ne vazhdimësi	-Bërja sa më transparente e punës	Po	
		2. Organizimi i fushatës me qytetare	ATK	Shtator 2009	-Ndërgjegjësimi dhe fitimi i besimit të publikut	Po	
		3. Menaxhimi i kutive të vërejtjeve dhe sugjerimeve	ATK	Ne vazhdimësi	-Rastet e ankesave ulen si pasojë ngrihet integriteti profesional i sistemit doganor	Po	
		4. Organizimi i seminareve me tatimpagues	ATK	Në Vazhdimësi	-Rritje e nivelit në punë dhe në zbatimin e detyrave -Menaxhim me i mirë i	Po	

		5. Hapjen e linjës telefonike online	ATK	Shtator 2010	parasë publike -Rastet qe qytetaret paraqesin ne baza vjetore -Masat e marra për çdo ankese apo informacion te dhënie	Po	
III. 16	Zhvillimi i procedurave për lëshimin e pëlqimeve mjedisore për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe lejeve	1. Monitorimi i zbatimit të ligjit nga Inspektorati i Mjedisit	MMPH AKMM (Organizata për monitorimin e mjedisit) KPMM Komunale	Në vazhdimësi	Shmangia e mundësisë për keqpërdorim të pëlqimeve mjedisore dhe lejeve ujore Aftësimi profesional dhe efikasiteti në punë 1.5 Bashkëpunimi me komunat dhe OJQ	Po	
		2. Organizimi i diskutimeve publike	MMPH Shoqëria civile, Komuniteti i biznesit.	Në vazhdimësi	-Ngritja e transparencës dhe gjithëpërfshirja ne vendimmarrje -Publiku ka besueshmëri me te larte dhe rritet niveli i cilësisë se mjedisit	Po	
		3. Zhvillimi i trajnimeve në ngritjen e aftësive inspektuese në fushën përkatëse	MMPH	Në vazhdimësi	-Aftësi te shtuara ne inspektime -Numri i inspektimeve te kryera me sukses dhe masat e marra nga to	Po	
III. 17	Minimizimi i mundësive korruptive gjate trajtimit te duhur te ndërtimeve pa leje	1. Hartimi dhe miratimi i Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje	MMPH ZKM, MTI, MD, MPSH, Komunat, Shoqata e arkitektëve të Kosovës, Shoqata e Ndërtimtarëve të Kosovës.	Dhjetor 2009	- Miratimi dhe zbatimi i ligjit - Krijimi i mekanizmave funksional dhe efikas, eliminimi i praktikave korruptive dhe jo te mira	Po	
III. 18	Ngritja e përgjegjësisë, dhe	2. Trajnimi i zyrtareve komunal ne fushën e korrupsionit	MAPL, ZKM/ZQM,	Ne vazhdimësi	-Shërbime komunale te efektshme, te përgjegjshme	Po	

	transparencës paanshmërisë të zyrtarëve komunal		KK, AKK, MSHP, Shoqëria civile.		pranë publikut dhe mënjanimi i rasteve korruptive -Zvogëlimi i ankesave nga ana e publikut për shërbimet e qeverisjes lokale		
III. 19	Rritja e kontrollit në menaxhimin e të hyrave vetanake të institucioneve të MKRS-së	1. Mbikëqyrja e inkasimit të hyrave vetanake në llogari të institucionit	MKRS, MEF.	Në vazhdimësi	Shmangia e mundësisë për keqpërdorimin e të hyrave vetanake	Po	
		2. Zbatimi i memorandumit të mirëkuptimit në mes të MKRS-MEF	MKRS, MEF.	Në vazhdimësi	-Ulen mundësitë për korrupsion -Bashkëpunimi tregon rezultat nga monitorimi i rregullt e i duhur i inkasimit -Zvogëlohen mundësitë për abuzim	Po	
III. 20	Shfrytëzimi i drejtë i buxhetit për linjën e subvencioneve dhe transfereve në lidhje me projektet për kulturë, sport dhe rini	1. Hartimi dhe nxjerrja e akteve nënligjore	MKRS, MASHT.	Dhjetor 2009	- Menaxhimi i mirë dhe efikas i projekteve - Projektet implementohen me sukses të matshëm - Transparencë në shpenzimin e subvencioneve dhe transfereve - Sistem i kontrollit të drejtë të subvencioneve	Po	
III. 21	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në realizimin e detyrave të MKK-se	1. Pengimi i konfliktit të interesit gjatë realizimit të projekteve dhe detyrave tjera në kuadrin e MKK-ës dhe krijimi i kushteve adekuate për qasje në informata (databazën) e projekteve.	MKK, AAK.	Në vazhdimësi	- Parandalimi i mundësisë për korrupsion - Veprimi konform dispozitave ligjore - Ngritja e transparencës së plotë dhe bërja transparente e të dhënave - Ngritja e vetëdijes së shërbyesve civil dhe minimizimi i rasteve të konfliktit të interesit	Po	
III. 22	Plotësimi i kuadrit ligjor	1.Hartimi dhe miratimi i: -ligjit për energjinë	MEM, Rregullatori i	Dhjetor 2009	- Kompletimi i infrastrukturës ligjor	Po	

		-ligjit për energjinë elektrike -ligjit për rregullatorin e energjisë - ligjit për Miniera	Energjisë, Qeveria, Kuvendi.		-Rregullimi i fushave përkatëse dhe ulja e mundësive për abuzime -Nxjerrja e akteve nënligjore		
III. 23	Publikimi i te dhënave gjeoshkencore	1. Krijimi i GIS-it Nacional të Kosovës	MEM	Qershor 2010	Krijimi i gjeodatabazës qendrore me te dhënat e plota te gjeoshkencës dhe bërja transparente e këtyre te dhënave, me mundësi qasje për institucionet, sektorin privat si dhe opinionin i gjere.	Po	
		2. Përgatitja e kuadrit profesional me trajnime për përdorimin e softuerëve te GIS-it.	MEM	Dhjetor 2010	-Ngritja profesionale e stafit	Po	
		3. Krijimi i linkut në MEM për publikimin e aktiviteteve dhe informacioneve gjeoshkencore	MEM	Dhjetor 2010	-Bërja transparente e veprimeve dhe minimizimi i mundësive abuzive	Po	
III. 24	Rritja e transparencës se veprimeve te MEM	1. Krijimi i webfaqes se MEM për publikimin e aktiviteteve dhe informacioneve gjeoshkencore	MEM	Dhjetor 2009	Krijimi i transparencës se plot dhe bërja transparente e te dhënave -Qasje ne çdo kohe e publikut tek të dhënat -Llogaridhënie ne nivelin e duhur	Po	
III. 25	Transparence te plote ne zhvillimin e procedurave te prokurimit publike ne projektet investive, sidomos ne te ardhmen ne ndërtimin e kapaciteteve te reja energjetike “Kosove e Re”	1. Transparencës ne vlerësimin e tenderëve nga ana e komisioneve.	MEM, MEF , MMPH, MAPL, Pushteti lokal dhe institucionet tjera.	Në vazhdimësi	Zhvillimi i projekteve kapitale -Kryerja e veprimeve me fondet publike në mënyrë te qarte dhe te njohur për publikun -Minimizimi i favorizime ne proceset e prokurimeve publike	Po	
III. 26	Forcimi i kontrollit te brendshëm brenda	1. Themelimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm	MSH, Institucionet	Dhjetor 2009	-Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe	Po	

	Ministria e Shëndetësisë		Shëndetësore.		shtimi i vlerës. -Rekomandimet e ofruara për përmirësime.		
III. 27	Reforma institucionale, ngritja e praktikave të mira menaxhuese në sistemin shëndetësor dhe përfundimi i potencialit njerëzor në sektorin e shëndetësisë.	1. Thjeshtësimi i procedurave 2. Ndarja e qartë e kufirit privat dhe publik 3. Ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional (trajnime, seminare, udhëtime studimore etj.) 4. Edukimi i shëndetit të popullatës mbi rolin e shëndetit (broshura, reklama, media)	MSH; Qeveria, Institucionet shëndetësore, Shoqëria civile.	Në vazhdimësi	-Menaxhmenti i mirë -Efikasiteti në punë -Struktura e qarte -Ngritja e kapaciteteve njerëzore -Forcimi i funksionalizimit të Institucioneve -Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore -Funksionalizimi i sistemit të Informimit Shëndetësor -Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore (përmirësimi i sistemit të referimit, udhërrëfyesit, protokollet, termini për vizita, licencimi, akreditimi i Institucioneve shëndetësore dhe personelit shëndetësor dhe të tjetër).	Po	
III. 28	Krijimi i sistemit të qëndrueshëm të financimit për sektorin e shëndetësisë	1.Përcaktimi i Listës së shërbimeve shëndetësore themelore. 2.Përcaktimi normatives/standardeve të shërbimeve shëndetësore 3. Përcaktimi i kostos së shërbimeve shëndetësore.	MSH, Qeveria	Dhjetor 2009	-Miratimi i Projektligjit për Sigurime shëndetësore të Kosovës -Mirëfunksionimi i sistemit të qëndrueshëm të financimit për sektorin e shëndetësisë.	Po	
III. 29	Sigurimi i cilësisë, sigurisë, efikasitetit të produkteve medicinale, pajisjeve medicinale	1.Plotësimi i legjislacionit aktual si dhe nxjerrja e akteve nënligjore 2.Thjeshtësimi i procedurave apo ndryshimi i procedurave të regjistrimit në AKPM - importit 3.Vetëdijësimi i institucioneve relevante sa i përket heqjes së doganës për produkte	MSH, AKPM, Shërbimi Doganor i Kosovës, MEF, KRPP.	Dhjetor 2010	-Rritja e numrit të barnave të regjistruara sipas autorizim marketingut në Kosovë. -Ulja e mundësive korruptive dhe mosfurnizimi i tregut me barna	Po	

		medicinave.			-Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarit		
III. 30	Sigurimin e shërbimeve të mira farmaceutike që do të përfshijë menaxhimin e deponimit, distribuimit dhe disperzimit të produkteve farmaceutike	1. Vetëdijesimi i institucioneve relevante për hartimin e legjislacionit adekuat i cili do të krijonte monitorimin dhe rregullimin e çmimeve të barnave. 2. Thjeshtimi i procedurave të prokurimit për produkte medicinale - (me theks të veçantë në rastet emergjente).	MSH, Qeveria.	Qershor 2010	-Kontrolli i shpenzimeve të barnave dhe materialit shpenzues nga Lista Esenciale e shërbimeve në strukturat shëndetësore. -Unifikimi i çmimeve të barnave në treg -Sigurimi i barnave në afate me të shpejta për rastet emergjente. -Ulja e çmimit të barnave -Ulja e mundësive për abuzim me barnat e çmimet	Po	
III. 31	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve për funksionimin inspeksioneve	2. Rishqyrtimi i sistemit të mbikëqyrjes së brendshme të inspeksioneve	MBPZHR	Shtator 2009	Rritja e kontrollit ndaj punës së inspeksioneve	Po	
III. 32	Zbatimi i rekomandimeve të raporteve të auditimit të jashtëm edhe të brendshëm.	Publikimi i masave të ndërmarra në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga auditimet e brendshme dhe të jashtme	MBPZHR	Shtator 2009	Fuqizimi i kontrollit të brendshëm dhe ngritja e cilësisë në menaxhimin e burimeve financiare	Po	
III. 33	Përgatitja Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2010, përmes një sistemi transparent, në pajtim me praktikën evropiane e ndërkombëtare	1. Përcaktimi i politikave dhe procedurave për përgatitjen e buxhetit, si dhe përgatitja e planit për ciklin vjetor buxhetor; 2. Organizimi i dëgjimeve buxhetore me organizata buxhetore për buxhetet e viteve 2010, 2011 dhe 2012; 3. Monitorimi i buxhetit 2009 me theks të posaçëm Programi për	MEM	Dhjetor 2009	-Ngritja e transparencës në mënyrën e hartimit të buxhetit e politikave të shpenzimeve të tij - Miremenaxhimi i fondeve publike dhe ngritja e llogaridhënies	Po	

		Investime Publike, 4. Vlerësimi Ndikimeve Buxhetore për propozimet që shqyrtohen në Qeveri					
III. 34	Rritja e numrit të institucioneve private parashkollore, shkolla fillore, te mesme të ulëta dhe të mesme të larta.	1.Ofertimi transparent i licencave për institucione private.	MASHT	Në vazhdimësi	-Ngritja e transparencës ne ofertimi e licensave -Rritja e nivelit arsimor sipas standardeve	Po	
IV. Agjencitë Monitoruese, te Zbatimit te Ligjit dhe Gjyqësori							
